

ANALIZA E PASOJAVE SOCIALE TË LIGJIT PËR FALIMENTIMIN



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Përmbajtja

Pjesa 1 – Hyrja dhe qëllimi i kësaj analize	7
Pjesa 2 – Materiali dhe metodologjia e përdorur për përgatitjen e analizës dhe problematikat e hasura	9
Pjesa 3 – Dimensioni social i falimentimit, perspektivat ndërkombëtare dhe LF-ja	10
3.1. Disa pasoja sociale dhe psikologjike të falimentimit të mbledhura nga përvoja ndërkombëtare	10
3.2. Pasojat juridike të falimentimit në kontekstin shqiptar	12
3.3. Pasojat e drejtpërdrejta të falimentimit tek debitorët individual	14
3.3.1. Shtëpia e debitorit	16
3.3.2. Llogaritë bankare të Debitorit	17
3.3.3. Pasojat mbi pensionin	17
3.3.4. Pasojat mbi policën e sigurimit të jetës, fondin e investimeve dhe investimet e tjera private	17
3.3.5. Pasojat në veprimtarinë tregtare dhe marrëdhëniet e punës	18
3.4. Pasojat e falimentimit që prekin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë punonjësit e debitorit	19
3.4.1. Ndikimi i falimentimit në punësim	19
3.4.2. Përvoja ndërkombëtare	20
3.4.3. Kodi shqiptar i Punës dhe pasojat që mund të vijnë nga zbatimi i tij	21
Pjesa 4 – Raste praktike mbi ndikimin social të falimentimit tek shoqëritë e mëdha tregtare në Shqipëri	23
Pjesa 5 – Përfundime	25

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W.
Washington, D.C. 20433 Internet: www.ifc.org

Materiali mbrohet nga e drejta e autorit. Kopjimi dhe/ose transmetimi i pjesëve ose i gjithë këtij materiali pa leje mund të përbëjë shkelje të ligjit në fuqi. IFC-ja nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë material, apo për përfundimet ose gjykimet e përshkruara këtu, dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë lëshim ose gabim (përfshirë, pa kufizime, gabime tipografike dhe teknike) në çfarëdo përmbajtjeje ose për mbështetje në të.

Rreth IFC-së

IFC, një anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2021, ne kemi investuar një shumë rekord prej 31.5 miliardë dollarë në shoqëri private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët ndërsa ekonomitë përballen me ndikimet e pandemisë COVID-19. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org.

RRETH AUTORËVE

KALO & ASSOCIATES (themeluar më 1994) është një zyrë ligjore e cila ofron shërbime ligjore në të gjitha aspektet e ligjit tregtar në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfaqësuar shoqëri dhe agjenci të shquara, të huaja dhe ndërkombëtare, përfshirë disa Fortune 500, që bëjnë biznes në një spektër të gjerë të industrive në të gjithë globin, përfshirë rajonin e Ballkanit. Zyra punëson avokatë të kualifikuar dhe të përkushtuar me përvojë të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve ligjore të sofistikuar dhe komplekse dhe transaksione sipas standardeve ndërkombëtare, në mjedisin lokal. Zyra administron me sukses dhe në kohën e duhur çështje tregtare për shkak të departamenteve të strukturuar: 1) Shoqëritë tregtare (M&A dhe JV), 2) Shërbime bankare dhe financiare, 3) Projektet (koncesione dhe PPP) në fushat e energjisë & burimeve natyrore, 4) Pronësia intelektuale (përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, etiketimin, shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale), 5) Punësimi & migracioni, dhe 6) Përfaqësimi në gjykatë, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. KALO & ASSOCIATES gëzon njohjen rajonale duke qenë një anëtar themelues i SEE LEGAL (South East European Legal Group), grupi drejtues rajonal i 10 zyrave ligjore, të cilat ofrojnë shërbime ligjore cilësore, duke përfshirë transaksione tregtare ndërkufitare në 12 juridiksione të SEE LEGAL që prej 2003.

ANDRÉS F. MARTÍNEZ është Specialist i Lartë në Sektorin Financiar në fushën e Falimentimit dhe Zgjidhjes së Borxhit, pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin. Andrés është diplomuar në fushën e të drejtës në vitin 2000 dhe ka praktikuar ligjin e falimentimit në një kompani të madhe ligjore në Argjentinë, që kur u pranua në dhomën e avokatëve (2001) deri në 2008, kur u bashkua me Grupin e Bankës Botërore. Ai ka drejtuar treguesin e "paaftësisë paguese" të "Doing Business" (të Bërit Biznes) të Grupit të Bankës Botërore deri në 2011 dhe që atëherë ka ofruar konsulencë në disa vende në lidhje me reformën në fushën e falimentimit dhe zgjidhjes së borxhit, në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Azinë Lindore dhe Lindjen e Mesme. Në pozicionin e tij aktual, ai drejton dialogun me disa qeveri në lidhje me çështje teknike në fushën e zgjidhjes së borxhit dhe paaftësisë paguese.

SERGIO A. MURO punon si Konsulent në fushën e Falimentimit dhe Zgjidhjes së Borxhit (me fokus tek falimentimi dhe zbatimin e kontratës), pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin. Që në vitin 2016, ai ka ofruar konsulencë vendeve të ndryshme mbi reformën për zgjidhjen e borxhit, duke përfshirë sistemet e falimentimit dhe rekuperimin e borxhit në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Azinë Lindore, dhe Lindjen e Mesme. Përveç kësaj, ai drejton Projektin e Gjykatës së Lartë Argjentinase në Universidad Torcuato Di Tella, ku ai studion mënyrën si merren vendimet e Gjykatës së Lartë.

PROJEKTI DHE PËRBËRJA E GRUPIT

Menaxheri i Projektit | Igor Matijevic, është një Specialist i Lartë i Sektorit Financiar në Departamentin e Këshillimit për Krijimin e Tregjeve pranë Grupit të Bankës Botërore (IFC / WBG), me eksperiencë prej 15 vitesh në këtë organizatë ndërkombëtare në disa shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) me fokus kryesisht në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ai është Menaxher Rajonal i Projektit Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi në Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilit organizon dhe lehtëson zbatimin e tij në pesë shtete (Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Serbi) nëpërmjet komunikimit dhe koordinimit me klientët qeveritar, agjencitë dhe institucionet, si dhe rrjetit të gjërë të palëve të interesit ndërkombëtar dhe lokal. Z. Matijevic zotëron dije të thella dhe eksperiencë në legjisllacionin dhe zbatimin e zgjidhjes së borxhit, shoqëruar me një mirëkuptim të fortë në mundësimin e biznesit dhe në reformat e sektorit financiar.

Koordinatorja e Projektit | Irena Gribizi, i është bashkuar IFC-së që në vitin 2001 dhe ka punuar si Drejtuese Operacionale për menaxhimin e disa projekteve në Shqipëri me fokus zhvillimin e sektorit privat. Nga viti 2012 znj. Gribizi, Profesioneiste e Certifikuar në Menaxhimin e Projektit (PMP) është angazhuar si konsulente për IFC-në/Grupin e Bankës Botërore dhe në cilësinë e koordinatorës për Shqipërinë ka drejtuar projektet për përmirësimin e klimës ku operon biznesi, ku mund të përmendim: Thjeshtësimi i Taksave dhe Transferimi i Çmimit, Logjistika Tregtare në Ballkanin Perëndimor, Klima e Investimeve dhe Konkureshmëria në Agrobiznes, Mbështetja për Lehtësimin e Tregtisë dhe Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi. Si pjesë e projektit të fundit, ajo ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në negociatat me klientët qeveritarë, në hartimet e propozimeve për projektin, në koordinimet e aktiviteteve në vend dhe në menaxhimin e gjithë ekipit lokal dhe të huaj për projektin. Znj. Gribizi ka mbështetur projektin veçanërisht në disa seminare të nivelit të lartë me zyrtarë të qeverisë, sikurse ka drejtuar me sukses procesin e hartimit të ligjit të ri për falimentimin në Shqipëri.

Nën mbikqyrjen e: Damien Shiels, Menaxher i Praktikës (IFC AS), në Evropën Lindore & Azinë Qendrore, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin dhe Mahesh Uttamchandani, Menaxher i Praktikës, EFNFI, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin.

1 Hyrja dhe qëllimi i kësaj analize

Në kuadër të Fazës së II-të të Projektit të Zgjidhjes së Borxhit, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore (WBG), me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), kërkoi përgatitjen e një studimi në lidhje me ndikimin social të rasteve të falimentimit të kërkuara nga debitori në Shqipëri në zbatim të ligjit të ri nr. 110/2016 "Për Falimentimin" ("LF"). LF-ja është miratuar dhe është në fuqi për më shumë se katër vjet, por deri më sot nuk është bërë asnjë studim që të jetë thelluar për pasojat e tij sociale. Për të ndihmuar në plotësimin e këtij boshllëku, ky studim do të fokusohet në kuptimin e ndikimeve të LF-së tek individët, familjet, bizneset dhe pasojat sociale që mund të sjellë falimentimi i debitorëve të prekur.

Falimentimi është një proces universal dhe i zakonshëm. Në fakt, figura publike shumë të shquara si Mark Twain, Walt Disney, Elton John dhe Henry Ford, të gjithë kanë kërkuar falimentim në një moment të jetës së tyre. Përdorimi i zgjuar i të ardhurave dhe kredisë pas falimentimit mund të jetë një metodë që debitori të rifitojë qendrueshmërinë e tij financiare. Në fakt, Mark Twain, Walt Disney, Elton John dhe Henry Ford të gjithë patën një të ardhme të begatë - duke treguar se jo vetëm që është e mundur që një debitor të lërë pas falimentimit, por edhe të ketë sukses më vonë^[1].

LF-ja u hartua për të ofruar një sistem më të parashikueshëm i cili krijon një ekuilibër më të mirë midis të drejtave të debitorëve dhe kreditorëve dhe gjithashtu shërben si një mjet rehabilitimi për debitorët në vështirësi të mëdha financiare. Ligji i ri ofron mënyra të përmirësuar për riorganizimin e debitorëve, një zhvillim i mirëpritur duke marrë parasysh numrin në rritje të bizneseve që nuk do t'i mbijetojnë krizës aktuale, pa kaluar nëpër procedurat e paafëtisë pague. Në situatën pas Covid-19, nevoja për të zbatuar në mënyrë efektive kuadrin e ri ligjor mbi Falimentimin në Shqipëri është edhe më e madhe. Prandaj, është e rëndësishme që të gjitha palët e interesuara, veçanërisht debitorët individual, të kenë në dispozicion një analizë që tregon pasojat social-ekonomike. Ky studim synon të përmbushë këtë rol, duke marrë në konsideratë dispozitat e ligjeve përkatëse shqiptare (p.sh. Kodi i Punës, legjisllacioni i mbrojtjes sociale, etj.) të cilat ofrojnë mekanizma mbështetës për grupet që mund të preken si pasojë e falimentimit, pavarësisht nëse është e mjaftueshme ose jo mbështetja e dhënë sipas këtyre regjimeve.

Deri më sot, pasojat sistematike të falimentimit mbi gjendjen sociale dhe ekonomike në vend, nuk janë studiuar plotësisht nga praktikuesit dhe studiuesit e ligjit. Ky raport përfaqëson përpjekjen e parë për të dokumentuar dhe analizuar ndikimin e falimentimit tek debitorët në kontekstin shqiptar. Autorët u përpoqën të trajtonin hendekun në

[1] Marrë nga artikulli "Jeta pas falimentimit" në Investopedia - <https://www.investopedia.com/articles/pf/07/after-bankruptcy.asp>

literaturë duke studiuar dhe interpretuar kuadrin ligjor shqiptar dhe duke identifikuar pasojat e falimentimit, si ato pozitive ashtu edhe ato negative, për kategori të ndryshme sociale si familja, puna, mbrojtja sociale, kujdesi për fëmijët, ose fusha të tjera përkatëse sociale.

Qëllimet e kësaj analize janë kryesisht pasojat social-ekonomike të falimentimit duke arritur sa më poshtë vijon^[2]:

- a) të përshkruajë ndikimin social dhe shtrirjen e LF-së nëpërmjet ndërveprimit të tij me pjesë të tjera të sistemit të mbrojtjes sociale nën kuadrin ligjor shqiptar;
- b) të analizojë ndikimin e falimentimit të biznesit duke marrë në konsideratë edhe ndikimet e likuidimit mbi punonjësit, familjet, pasuritë dhe kapitalin e debitorëve dhe kostot sociale që vijnë më pas;
- c) të përcaktojë pasojat nga procesi i falimentimit tek individët dhe si mekanizmat e mbrojtjes sociale në Shqipëri janë të orientuara drejt lehtësimit të jetës së këtyre individëve;

Pjesa II e këtij dokumenti do të vijojë duke përshkruar materialet dhe metodologjinë e përdorur në këtë Analizë dhe sfidat e matjes së ndikimit social duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për të mbështetur një analizë të tillë. Pjesa III do të përshkruajë dimensionin social të ligjeve të falimentimit në përgjithësi dhe të LF-së në veçanti, e pasuar nga analiza aktuale ligjore e ndikimit të ligjit të falimentimit ndaj punonjësve, familjeve, pasurive, kapitalit të debitorëve dhe kostos sociale të falimentimit. Pjesa IV rendit përfundimet dhe rekomandimet për studime të mëtejshme në të ardhmen.

2 Materiali dhe metodologjia e përdorur për përgatitjen e analizës dhe problematikat e hasura

Metodologjia e punimit për sa i përket ndikimit social-ekonomik të falimentimit në Shqipëri përfshin qasjen e mëposhtme: (1) përshkrimin e pasojave sociale dhe ekonomike të falimentimit për debitorët, si dhe për njerëzit e tjerë të prekur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, si p.sh. anëtarët e familjes ose punonjësit e debitorit; (2) analizën e LF-së dhe pjesëve të tjera të legjislacionit që supozohet të ofrojnë mbrojtje për grupet vulnerabël dhe individët që preken nga falimentimi. Lidhja ndërmjet variablave të ndryshëm është kryer përmes interpretimit.

Kjo metodologji u përdor duke qenë se në Shqipëri informacioni dhe statistikat përkatëse në lidhje me procedurat e falimentimit janë të pamjaftueshme. Kështu, i'a vlen të përmenden disa nga kufizimet kryesore që u hasën në përgatitjen e kësaj analize, të cilat lidhen kryesisht me:

- a) mungesën e statistikave zyrtare gjithëpërfshirëse mbi dinamikën e vështirësive financiare dhe falimentimit në Shqipëri, duke kufizuar vlerësimin e shkallës reale të fenomenit dhe pasojat e tij të plota sociale;
- b) mungesën e politikave për trajtimin e shoqërive private në paaftësi paguese;
- c) mungesën e qendrave të këshillimit për të ndihmuar shoqëritë në paaftësi paguese; dhe,
- d) mungesën e këshillimit dhe ose ndonjë mbështetje tjetër për individët në paaftësi paguese.

Në përgjithësi, kufizimet e të dhënave na drejtojnë të fokusohemi kryesisht në përgjithësimet teorike, sistemimin e informacionit të disponueshëm dhe analizën e burimeve ndërkombëtare. Më pas kemi analizuar se si praktika ndërkombëtare në fjalë mund të ndërlidhet me situatën shqiptare, duke nxjerrë njohuri përkatëse të zbatueshme për kontekstin shqiptar.

[2] Në një fazë më të avancuar, mund të bëhen studime të mëtejshme nëpërmjet një ndërveprimi më personal me intervista të drejtpërdrejta të ish-punonjësve të shoqërive të falimentuara (dhe familjeve të tyre). Kjo duhet të përfshijë kryesisht raste të spikatura falimentimi dhe një grup mjaft specifik ish-punonjësish të këtij të fundit si ish-drejtorë ekzekutivë, ish-drejtorë të bordit, ish-kontabilistë etj. Duke pasur parasysh që kjo qasje e mundshme në të ardhmen kërkon një studim më të thelluar, AKF-ja mund të përfshijë autoritete të tjera si Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) për intervista dhe pyetësorë në terren.

Për të mundësuar sjelljen e studimeve të njëpasnjëshme që rrjedhin nga qasja bazë mbi ndikimin social të falimentimit që parashtrohet kjo analizë, në një nivel më analitik, Agjencia Kombëtare e Falimentimit (AKF) mund të luajë një rol kyç. Nëpërmjet funksionimit të duhur të mekanizmave statistikore të AKF-së, do të mblidhen të dhëna më të sakta dhe më të thelluara nga të gjitha rastet e falimentimit në Shqipëri. Të dhëna të tilla do të jenë të dobishme për të hedhur më shumë dritë mbi ndikimin që LF-ja ka në kontekstin social duke dhënë informacion të saktë për punonjësit e pushuar nga puna, fushën e veprimtarisë së shoqërive të likuiduara, etj. Të dhëna të tilla mund të vërtetohen më tej përmes intervistave të drejtpërdrejta me ish-debitorët, drejtuesit e tyre, punonjësit, etj.

3 Dimensioi social i falimentimit, perspektivat ndërkombëtare dhe LF-ja

Ligjet e falimentimit përgjithësisht mendohen si të natyrës thjesht ekonomike^[3]. Ky përgjithësim mund të konsiderohet i vërtetë edhe në kontekstin shqiptar, duke qenë se LF-ja është ngritur kryesisht mbi parimet e legjislacionit tregtar. Për individët në Shqipëri, koncepti i ligjit të falimentimit vazhdon të duket i huaj, siç tregohet nga numri minimal i çështjeve të regjistruara në gjykatë. Mungesa e rasteve nënkupton një nënvlerësim të aspekteve sociale të LF-së, i cili është gjithashtu, edhe pse jo gjerësisht, një ligj me karakter social^[4]. Si pjesë thelbësore dhe procedurale e legjislacionit, LF-ja trajton mënyrat për të adresuar vështirësitë financiare dhe ekonomike. Në përgjithësi, fryma e LF-së është të ofrojë lehtësim nëpërmjet procedurave të riorganizimit. Kështu, nëse individët bëjnë kërkesë për falimentim, sistemi ofron mënyra të rëndësishme rehabilitimi në rastet e vështirësive të mëdha financiare, madje edhe shkarkimit nga detyrimet. Përveç dispozitave të veta, LF-ja është e ndërthurur me aspekte të tjera të legjislacionit shqiptar që ndikojnë në mirëqenien sociale të individëve të falimentuar.

Ndërsa gjendja e paaftësisë paguese mund të jetë shumë e rëndë për debitorët individualë, sistemi i falimentimit ofron disa mënyra për të zbutur këto efekte. Për shembull, një çlirim nga borxhet para falimentimit për sipërmarrësit persona fizikë mund t'i lejojë ata të kenë një fillim të ri dhe të kapërcejnë ndikimet negative të shkaktuara nga vështirësitë financiare.

3.1. Disa pasoja sociale dhe psikologjike të falimentimit të mbledhura nga përvoja ndërkombëtare

Falimentimi shpesh mendohet si diçka që duhet shmangur, ose më mirë si një mjet i fundit për ata që kanë shteruar të gjitha opsionet e tjera për shlyerjen e borxheve të tyre. Konkretisht, ajo që duhet shmangur nuk është procedura e falimentimit, por situata që e bën të domosdoshme përdorimin e sistemit të falimentimit. Procedura e falimentimit është, nga ana tjetër, një mundësi e ofruar nga sistemi ligjor për të ndihmuar debitorët të shlyejnë detyrimet e tyre dhe, për individët, të vazhdojnë me biznesin dhe/ose jetën e tyre personale.

Si një çështje e cila rregullohet nga ligjet dhe faktet, edhe Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara ka theksuar se qëllimi i falimentimit ka qenë t'u japë debitorëve të ndershëm

[3] Zywicki, Todd J. 2001. "Ligji i falimentimit si Legjislacion Social". George Mason Law & Economics Research, (Korrik), 1-2. <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.273988>.

[4] Zywicki, Todd J. 2001. "Ligji i falimentimit si Legjislacion Social". George Mason Law & Economics Research, (Korrik), 1-2. <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.273988>.

por fatkeq një mundësi të re për të ardhmen, të pacenuar nga presioni dhe dekurajimi i ardhur si rrjedhojë e borxhit të mëparshëm^[5]. Megjithatë, deri më sot në Shqipëri nuk ka pasur asnjë vendim të Gjykatës së Lartë që të ofrojë një interpretim të ngjashëm në lidhje me falimentimin, pavarësisht se përfitimet nga përdorimi i procedurës së falimentimit janë marrë vazhdimisht prej vitesh në disa juridiksione.

Studimet ndërkombëtare sugjerojnë se ndikimet e tërthorta të vështirësive financiare ose ekonomike para dhe gjatë falimentimit mund të jenë gjithashtu të rëndësishme. Një shqetësim kryesor social lidhet me ankthin dhe madje edhe depresionin që mund të shkaktohet nga vështirësia financiare. Mishra Pihu dhe Sushanta Kumar në artikullin e tyre "Pasoja sociale të Ligjit për Falimentimin" kanë deklaruar se ankthi i vazhdueshëm që vjen nga paaftësia për të paguar ose nga ngacmimet nga kreditorët mund të shkaktojë probleme serioze emocionale dhe probleme të tjera për debitorët persona fizikë, duke përfshirë depresionin dhe distancimin social^[6]. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe në Shqipëri, ku simptoma të ndryshme si ankthi dhe distancimi social mund t'i bëjnë individët në gjendje të paaftësisë paguese të ngacmuar nga kreditorët dhe kështu të thellojnë më tej problemet e tyre psikologjike^[7]. Një pasojë tjetër e falimentimit është stresi, siç theksohet nga Grupi i Punës së task forcës së Bankës Botërore mbi Falimentimin dhe Regjimet e Kreditorit/Debitorit për Trajtimin e Paaftësisë Paguese të Personave Fizikë. Debitorët dhe punonjësit e debitorit që janë përballur me një proces falimentimi të përfunduar nëpërmjet likuidimit, mund të vuajnë nga simptomat e stresit si mungesa e gjumit, pamundësia për t'u përqendruar, vështirësi në komunikim me të tjerët, etj.

Ali, O'Brien dhe Ramsay kanë treguar se debitorët që kanë përdorur sistemin e falimentimit raportojnë se ndikimet pozitive të kërkesës për falimentim priren të tejkalojnë ato negative.^[8] Rezultatet e anketës së tyre tregojnë qartë se procedurat e falimentimit ofrojnë përfitime reale dhe domethënëse për shumë debitorë. Debitorët theksuan se falimentimi kishte dëmtuar marrëdhëniet me "miqtë e vjetër dhe të afërmit", duke shkaktuar ndjenja sikleti, turpi dhe poshtërimi dhe një dëshirë për të mbajtur të fshehtë shqetësimin e tyre financiar. Kur u pyetën për shëndetin e tyre fizik dhe mendor, marrëdhëniet, administrimin financiar dhe aftësinë për të përballuar shpenzimet e përditshme, shumica e debitorëve aktualë dhe të mëparshëm raportuan vazhdimisht se situata e tyre ishte "përmirësuar" pas falimentimit, e cila rrjedh nga lehtësimi i ofruar nga sistemi. 77% thanë se aftësia e tyre për të administruar financat e tyre ishte përmirësuar pas shpalljes së falimentimit, ndërsa 70% thanë se "cilësia e tyre e përgjithshme e jetës" ishte përmirësuar pas shpalljes së falimentimit. Gjithashtu, mbi 50% e debitorëve raportuan përmirësime në shëndetin e

[5] 5 Local Loan Co. kundër Hunt, 292 U.S. 234, 244 (1934).

[6] Mishra, Pihu., Das, Sushanta Kumar. 2020. "Degëzimet Sociale të Ligjit për Falimentimin". Bordi i Paaftësisë Paguese dhe Falimentimit të Indisë, (Tetor), <https://www.ibbi.gov.in/resources/articles?title=social&date=>

[7] <https://www.monitor.al/covid-19-shton-depresionin-ne-vend-rritet-ndjeshem-konsumi-i-qetesuesve/>

[8] Ali, O'Brien and Ramsay. 2017. "Falimentimi dhe rehabilitimi i debitorit: një studim empirik australian", Rishikimi i Ligjit të Universitetit të Melburnit, vëll. 40, nr.3, faqe 688-737, 2017

tyre fizik dhe mendor, marrëdhëniet me të tjerët dhe jetën familjare.

Studimet dhe artikujt ndërkombëtarë të shqyrtuar nga autorët dhe të përmendur më lart, treguan se dalja nga falimentimi në përgjithësi mund të ketë një ndikim pozitiv në rrethanat financiare, shëndetin dhe mirëqenien e debitorëve, të cilat zakonisht ndikohen -shpesh në mënyrë të konsiderueshme- nga rënia e gjendjes financiare të debitorit.

3.2. Pasojat juridike të falimentimit në kontekstin shqiptar

Paaftësia paguese shpesh nuk është aspak e dëshiruar dhe shihet si një masë ekstreme si nga individët por edhe nga shoqëritë në kontekstin social-ekonomik shqiptar, një situatë e cila konsolidohet me hapjen e një çështje falimentimi. Pavarësisht përdorimit të tij dhe përpjekjeve të politikëbërësve shqiptarë për të reduktuar stigmatizimin që mbart, konotacionet negative duket se vazhdojnë siç sugjerohet nga statistikat periodike që tregojnë një numër shumë të ulët kërkesash falimentimi të depozituara^[9]. Për disa, falimentimi mund të vazhdojë të perceptohet si konfirmim zyrtar i dështimit financiar, duke i bërë ata të hezitojnë të shpallin falimentimin. Falimentimi ende nuk është parë gjerësisht si një mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e vështirësive financiare, për të vazhduar biznesin si dhe jetën e zakonshme pas shlyerjes së detyrimeve.

Përfitimi më i menjëhershëm dhe më i prekshëm në lidhje me kërkesën për falimentim është se me fillimin e procedurave gjyqësore, të gjithë kreditorët ndalohen të mbledhin borxhet e tyre. Kjo çon menjëherë në dekurajimin e kreditorëve për të thirrur apo paditur dhe gjithashtu këta të fundit ndalohen të marrin në zotërim ndonjë prej pasurive të debitorëve^[10]. Në fund të të gjithë procesit të falimentimit, borxhet e pranuar të debitorëve konsiderohen si "të falura". Si pasojë, një debitori nuk i kërkohet më t'i shlyejë ato, duke rifituar lirinë financiare për t'ia filluar nga e para. Në nivel të përgjithshëm, debitori është në gjendje të përfitojë nga një pezullim i përkohshëm i veprimeve përmbarimore individuale, qoftë të dhëna nga një autoritet gjyqësor apo administrativ ose nga zbatimi i ligjit, me qëllim mbështetjen e negociatave për një plan riorganizimi, në mënyrë që të jetë në gjendje të vazhdojë të funksionojë ose të paktën të ruajë vlerën e pasurisë së tij gjatë negociatave^[11]. Për më tepër, debitorët që i nënshtrohen procedurave të falimentimit mund të kualifikohen për përjashtime që mbrojnë disa pasuri jetike nga likuidimi dhe rrjedhimisht transferimi te kreditorët.^[12]

[9] Këto ofrohen nga Gjykatat Rajonale.

[10] Shiko Neni 69 i LF-së

[11] Edhe pse është e vërtetë që ka një kosto procedurale për shpalljen e falimentimit personal, në shumicën e rasteve pasojat në jetën personale si marrja e thirrjeve ngacmuese nga kreditorët, përballja me një ulje të mundshme të pagave ose pamundësia për të paguar borxhet plotësisht, i rëndojnë shumë këto kosto dhe çojnë drejt kërkesës për falimentim duke qenë një rrugë shumë më e qëndrueshme për debitorin.

[12] Ekzistojnë gjithashtu shembuj të borxhit që nuk mund të shlyhen të cilët renditen në nenin 169 të LF-së dhe përfshijnë mbështetjen e fëmijëve, alimentacionin, disa kredi studentore, shlyerjet e divorcit dhe disa taksa mbi të ardhurat.

Nga ana tjetër, duke qenë se një nga parakushtet për hapjen e një procesi likuidimi është pamundësia për të shlyer borxhet që prekin personin fizik, falimentimi përmes likuidimit mund të ndikojë negativisht tek debitorët - por kjo është rrjedhojë e statusit të paaftësisë paguese, jo e vetë procesit. Mos shpallja e falimentimit i lejon kreditorët të vazhdojnë të ndërmarrin veprime individuale rikuperimi, gjë që nuk është domosdoshmërisht një zgjidhje në asnjë rast. Duke marrë në konsideratë përvojën e vendeve të tjera dhe trajtimin e pasojave të LF-së nga legjislacioni shqiptar, dalim në konkluzionin se disa nga pasojat e kësaj situatë të vështirësisë ekstreme financiare mund të jenë^[13]:

- **Të ardhura më të ulëta ose asnjë e ardhur për veten dhe familjen:**

Duke qenë se debitorët individualë dhe punonjësit e shoqërive në paaftësi paguese kanë shumë për të humbur, pasi jetesa e familjeve të tyre në përgjithësi varet nga pagat dhe përfitimet nga puna e kryer.

- **Vlerësimi negativ i kredisë:**

Vlerësimi shumë i ulët i kredisë mund ta bëjë më të vështirë marrjen e kredive në të ardhmen.

- **Humbja e privatësisë:**

Duke qenë se emri i individit të falimentuar do të futet në një regjistër publik kur të fillojnë procedurat e falimentimit.

- **Ndikimi në financat dhe pasuritë e partnerit:**

Pasuritë e përbashkëta si shtëpia ose makina mund të kenë nevojë të shiten. Borxhet e përbashkëta mund të nënkuptojnë se një partner ose anëtar i familjes i kërkohet të paguajë vetë të gjithë borxhin.

- **Arsimimi i fëmijëve:**

Vështirësi e shtuar për të paguar për arsimin e lartë të ardhshëm të fëmijëve ose ndërprerja e arsimit aktual në një institucion arsimor specifik (për shembull familjet që kanë investuar në institucione private ose në një institucion arsimor të huaj për fëmijët e tyre janë më të prirura për pasoja të rënda nga falimentimi. Prandaj familjet mund të jenë të prirura të vuajnë ekonomikisht, gjë që mund të çojë si pasojë ekstreme në ndërprerjen e mundshme të arsimit në institucione të tilla)^[14].

[13] Autoriteti Australian i Sigurisë Financiare. 2021. "Pasojat e falimentimit", Akseuar në tetor, 2021. <https://www.afsa.gov.au/insolvency/cant-pay-my-debts/consequences-bankruptcy>

[14] Sistemi arsimor shqiptar konsiderohet publik. Në Universitetet Publike Shqiptare kërkohet ende një pagesë vjetore regjistrimi që duhet paguar nga studentët. Duke marrë parasysh të ardhurat mesatare në Shqipëri dhe çmimin mesatar për regjistrimin në Universitete Publike, ka një mospërputhje të lartë e cila sjell në pamundësi pagese.

- **Humbja e pronave:**

Marrjen e shtëpisë nga bankat ose në një ankand publik të organizuar nga kreditori ose administratori i falimentimit, çka mund të rezultojë në lënien e debitorit si të pastrehë. Pasuri të tjera të rëndësishme gjithashtu mund të humbasin gjatë falimentimit.

3.3. Pasojat e drejtpërdrejta të falimentimit tek debitorët individual

Për qëllime të analizimit të pasojave të tjera nga një këndvështrim social, më poshtë jemi fokusuar në falimentimin e një individi pasi është më e arsyeshme dhe praktike të përcaktohen pasojat e një debitorit individual dhe jo të një shoqërie.

Shqipëria duket se nuk e vë theksin në harmonizimin e rregulloreve të parashikuara nga kuadri i ri i falimentimit me ato që mbulojnë aspekte të tjera sociale, si punësimi, mirëqenia sociale, pasuritë e paluajtshme dhe bankat. Neni 68 i LF-së përcakton se debitorit, si person fizik, ka të drejtë të marrë nga masa e falimentimit minimumin e shpenzimeve të jetesës gjatë procesit të likuidimit.^[15] Kjo vlerë përcaktohet nga administratori i falimentimit ose nga ai mbikqyrës, pas konsultimit me komitetin e kreditorëve ose, kur ky komitet nuk ekziston, me gjykatën e falimentimit dhe nuk mund të jetë më e vogël se minimumi^[16] i përcaktuar në legjislacionin për përkrahjen sociale. Vlen të theksohet se e drejta për shpenzimet minimale të jetesës është një e drejtë absolute dhe e pamohueshme si parim ligjor në Shqipëri^[17]. Si e tillë, disa pasuri përjashtohen nga sekuestrimi, si për shembull:

- sendet e përdorimit personal të debitorit dhe familjes së tij si: veshjet, shtrojet dhe mbulesat, mobiljet në masën që janë të nevojshme për jetesën e tyre;
- ushqimet dhe karburantet që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij deri në tre muaj;
- dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
- librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij.
- deri 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat

[15] Shpenzimet e jetesës duhet të përmbushin nevojat bazë të debitorit, fëmijëve të mitur nën përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e debitorit, përfshirë edhe ata që ndjekin shkollën deri në moshën 25 vjeç, bashkëshorten dhe ish-bashkëshorten, sipas detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

[16] Sipas një përllogaritjeje të Avokatit të Popullit, minimumi jetik është 17,875 lekë (rreth 160 USD). Megjithatë, ende nuk ka një vlerë minimale të përcaktuar nga legjislacioni social.

[17] Neni 533 i Kodit të Procedurës Civile (pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi).

që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;

- ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;
- për frutat natyrore një muaj para se të pihen^[18].

Parimet e mësipërme janë të zbatueshme edhe në përcaktimin e shpenzimeve minimale të jetesës në rast të ekzekutimit të masës së falimentimit të debitorit në paaftësi pague. Vetëm pasi ato të jenë lënë mënjanë, masa e falimentimit mund të ekzekutohet për të shlyer kreditorët.

Përveç sa më sipër, një nga efektet më të rëndësishme të LF-së, nëse jo më i rëndësishmi është e drejta e debitorit për t'u shkarkuar nga pretendimet e çdo kreditori, bashkë debitorit, dorëzanësi ose çdo personi tjetër kundër tij në të njëjtën mënyrë siç shkarkohet nga pretendimet e kreditorëve të falimentimit.^[19] Kjo do të thotë se debitorit individual do të përfitonte nga një "shkarkim" dhe një fillim i ri kundrejt pretendimeve të tyre përpara falimentimit. Edhe pse përvoja e deritanishme me përdorimin e mekanizmave të LF-së është shumë e kufizuar dhe dispozitat për shlyerjen mbeten të pa provuara deri më sot, nëse kjo e drejtë përdoret, ka shumë mundësi që pretendimet përpara falimentimit të fshihen dhe të shlyhen plotësisht duke mundësuar debitorin të vazhdojë veprimtarinë e tij tregtare. Nëse një debitor nuk e paraqet kërkesën për falimentim, çdo e ardhur e re që ai fiton duhet të përdoret për të shlyer borxhet e vjetra, duke mos e lehtësuar presionin e ndjerë nga debitorët në paftësi pague, dhe duke dekurajuar gjithashtu sipërmarrjen. Përkundrazi, procedurat e falimentimit mund të ofrojnë zgjidhje për vështirësinë financiare të debitorit, duke përfshirë një proces ristrukturimi që u mundëson kreditorëve në vështirësi financiare të vazhdojnë veprimtarinë tregtare.^[20]

Një synim i ngjashëm përkrahet dhe nga Direktiva e Ristrukturimit Parandalues (2019/1023/BE) e cila parashikon në pjesën Hyrëse që një legjislacion ristrukturimi duhet të jetë në dispozicion të kreditorëve, duke përfshirë personat juridikë, personat fizikë dhe grupet e shoqërive, për t'i dhënë mundësi që të trajtojnë vështirësitë e tyre financiare në një fazë të hershme, kur ka gjasa që paftësia e tyre pague të mund të parandalohet dhe të sigurohet qëndrueshmëria e biznesit. Një kuadër ligjor ristrukturimi duhet të jetë i disponueshëm përpara se një debitor të bëhet i paftë për të paguar sipas ligjit kombëtar,

[18] Neni 529 i Kodit të Procedurës Civile.

[19] Të drejtat e kreditorëve të falimentimit ndaj debitorëve dhe dorëzanësve të debitorit, si dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga një njoftim i regjistruar si me përparësi ose si kreditorë të siguar do të mbeten të paprekura.

[20] Ky vazhdim mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, duke ndryshuar përbërjen, kushtet ose strukturën e pasurive dhe detyrimeve të tyre ose çdo pjesë tjetër të strukturës së tyre të kapitalit, duke përfshirë shitjet e pasurive ose pjesëve të biznesit.

domethënë përpara se debitori të plotësojë kushtet sipas ligjit për të filluar procedurat kolektive të falimentimit, të cilat zakonisht sjellin një largim total të debitorit dhe emërimin e një likuiduesi. Për të shmangur keqpërdorimin e kuadrove ligjore të ristrukturimit, vështirësitë financiare të debitorit duhet të konsiderohen si gjasa për falimentim dhe plani i ristrukturimit duhet të jetë në gjendje të parandalojë paaftësinë paguese të debitorit dhe të sigurojë qëndrueshmërinë e biznesit. Kjo hyrje e përgjithshme përfshihet plotësisht në Ligjin shqiptar të Falimentimit dhe efektet e përfundimit të një procedure falimentimi nëpërmjet ristrukturimit synojnë pikërisht shlyerjen e borxhit dhe mundësinë e një fillimi të ri për debitorin. Kjo mundësi pothuajse nuk ofrohet në asnjë legjislacion tjetër në Shqipëri.

3.3.1. Shtëpia e debitorit

Ndoshta pasoja më e njohur e falimentimit është humbja e pasurisë. Procedurat e falimentimit mund të kërkojnë që debitori të heqë dorë nga pasuria, dhe ajo të nxirret për shitje në mënyrë që të shlyejë kreditorët. Në rrethana të caktuara, falimentimi mund të nënkuptojë humbjen e pasurive të paluajtshme, automjeteve, bizhuterive, orendive antike dhe llojeve të tjera të pasurive.

Në përgjithësi, nëse debitori është pronar i shtëpisë, vetëm ose bashkërisht, me hipotekë ose të lirë nga ndonjë barrë, interesi i debitorit në shtëpinë e tij do të jetë pjesë e masës së falimentimit që do të trajtohet në procedurën e falimentimit. Nëse debitori është ai që paraqet kërkesën për falimentim, ai mund të mbajë administrimin e shtëpisë derisa shtëpia të dalë në ankand nga Përmbaruesi. E drejta e debitorit për të mbajtur administrimin e shtëpisë konsiderohet si një veprim i zakonshëm administrimi sipas LF-së dhe i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm nga një administrator mbikqyrës i caktuar nga gjykata. Administratori mbikqyrës autorizon paraprakisht të gjitha veprimet e disponimit që janë jashtë objektit të veprimtarisë së zakonshme të administrimit (p.sh. shtëpia e debitorit e lënë peng ndaj bankës) ose që nuk përbëjnë veprime të ruajtjes së thjeshtë të pasurisë.^[21]

Bazuar në përvojën praktike në Shqipëri, një çështje e rëndësishme për sa i përket strehimit është sigurisht trajtimi i hipotekave të pasurive të pa luajtshme. Shumica e debitorëve kanë pak pasuri me vlerë që janë përdorur ose mund të përdoren si kolateral për borxhet. Në rastet që kanë të bëjnë me pretendimet e siguruar në përgjithësi dhe hipotekat në veçanti kreditorët zakonisht e kanë sekuestruar kolateralin nëpërmjet procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, pa qenë nevoja që debitori të paraqesë kërkesën për falimentim^[22]. Megjithatë, derisa shtëpia e hipotekuar të shitet,

[21] Shih nenin 60 të LF-së. Përfundimisht, një administrator mbikqyrës mund të kërkojë gjithashtu heqjen e kompetencave të administrimit, tërësisht ose pjesërisht, ndaj një debitorit.

[22] Mekanizmat e ekzekutimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile nuk mund të zbatohen kur ka filluar një procedurë falimentimi, duke qenë se pas fillimit të procedurës së falimentimit nuk mund të bëhen ekzekutime të reja mbi pasurinë e debitorit dhe ato që kanë filluar duhet të pezullohen. Neni 137 i LF-së përcakton se në rast likuidimi në pjesë të ndryshme, shitja e pasurive kryhet me ankand, në përputhje me dispozitat përkatëse

shtëpia do të vazhdojë t'i përkasë debitorit dhe do të përfshijë çdo zmadhim ose zvogëlim të vlerës së saj.

Nëse debitori përdor një shtëpi të marrë me qira, kjo kontratë nuk mund të zgjidhet nga qiradhënësi pas fillimit të procedurës së falimentimit për shkak të mos shlyerjes së qirasë përpara fillimit të procedurës së falimentimit, ose si rrjedhojë e përkeqësimit të gjendjes financiare të debitorit. Megjithatë, mos përmbushja e detyrimeve të qirasë pas fillimit të procedurës së falimentimit i jep qiradhënësit të drejtën për të zgjidhur kontratën.^[23]

3.3.2. Llogaritë bankare të Debitorit

Kur fillon procedura e falimentimit, llogaria bankare, duke përfshirë të gjitha pasuritë e debitorit bëhen pjesë e masës së falimentimit. E drejta e debitorit për administrimin dhe disponimin e pasurisë është e kufizuar. LF-ja parashikon që debitori duhet të bëjë pagesat ndaj kreditorëve të tij vetëm nëpërmjet administratorit të falimentimit ose kujdestarit të tij (siç caktohet nga administratori) nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga kreditorët. Përndryshe, nëse debitori paraqet kërkesën për falimentim, e drejta e debitorit për administrimin dhe shitjen e pasurisë së tij kufizohet në veprimet e zakonshme të administrimit (shpesh të përshkruara si në zotërim të debitorit).

Paratë që i detyrohen bankës do të konsiderohen si borxh në falimentim dhe debitori nuk duhet të marrë asnjë overdraft ose kredi pa e njoftuar bankën se është në procedurë falimentimi.

3.3.3. Pasojat mbi pensionin

Një administrator falimentimi bazuar në kuadrin ligjor shqiptar për falimentimin nuk mund të kërkojë klasifikimin e pensionit si pasuri sepse teknikisht pensioni është një e drejtë e dhënë nga shteti për individin, ndërsa pronësia e fondit të pensioneve mbahet nga shteti dhe si rrjedhojë nuk mund të sekuestrohet nga administratori i falimentimit. Megjithatë, çdo shumë e grumbulluar mbi shumën minimale të shpenzimeve të jetesës mund të bëhet pjesë e masës së falimentimit, e cila praktikisht do ta çojë mbajtësin e pensionit në varfëri.

3.3.4. Pasojat mbi policën e sigurimit të jetës, fondin e investimeve dhe investimet e tjera private

Në përgjithësi, administratori i falimentimit do të ketë mundësi të kërkojë çdo interes që individi i falimentuar ka në një policë sigurimi të jetës ose fond investimi. As LF-ja dhe as ligjet specifike për sigurimin dhe risigurimin, pensionet vullnetare dhe sipërmarrjet e

të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, të gjitha pasuritë e siguruar duhet të shiten në ankand nëpërmjet përmbaruesve (publik ose privat, sipas zgjedhjes së kreditorit) me anë të ankandëve publike të parashikuara në nenet 554 e në vijim të KPC-së. Prandaj kreditorët e siguruar si banka prirën të shmangin hapjen e procedurës së falimentimit pasi përfundimi është pothuajse i njëjtë, pasuria (shtëpia) do të shitet sërish përmes ankandit.

[23] Shih nenin 75 të LF-së.

investimeve kolektive nuk rregullojnë efektet ose pasojat mbi pasuritë e debitorit individual në paaftësi pagueuse, por nga interpretimi i përgjithshëm i frymës së LF-së, ne mund të themi se kur zotëruesi i një police sigurimi, pjesëmarrjes në një fond pensionesh ose investimi falimenton, polica/pjesa në fond bëhet pjesë e masës së falimentimit. Një supozim i tillë i përgjithshëm bazohet në parimin që të drejtat kontraktuale të debitorit sipas policës/pjesës së pjesëmarrjes në policë/fond kërkojnë që polica ose pjesa përkatëse e saj të përfshihet si pasuri e masës së falimentimit.

Edhe pse nuk ka praktikë gjyqësore në këtë drejtim, besojmë se për qëllime falimentimi edhe të ardhurat nga këto lloj investimesh do të jenë pjesë e masës së falimentimit. Ky interpretim bazohet në rregullin e përgjithshëm për pronësinë e të ardhurave nga policat e sigurimit dhe fondet e investimeve ose pensione. Të ardhura të tilla do të jenë pjesë e masës së falimentimit duke pasur parasysh që debitori do të ketë në një moment të caktuar të drejtën për të marrë dhe mbajtur të ardhurat kur bëhen të arkëtueshme nga siguruesi ose fondi i investimit.

Për rrjedhojë, administratori i falimentimit mund të ketë të drejtë të shtojë të ardhurat nga polica/pjesa e pjesëmarrjes në fond në masën e falimentimit, duke ndërhyrë kështu në një kontribut gjatë gjithë jetës së debitorit qoftë si investim, qoftë si pension privat.

Pavarësisht nga sa më sipër, ka një çështje që vlen të merret parasysh dhe që prek drejtpërdrejt nga një këndvështrim social një anëtar të familjes së debitorit të falimentuar. Nëse përfituesi i një police sigurimi, apo i një fondi pensionesh/investimi nuk është vetë debitori por një anëtar i familjes së tij, sipas këndvështrimit tonë situata ndryshon. Nëse përfituesi i të ardhurave është një anëtar i familjes apo edhe një palë e tretë e palidhur, të ardhurat do t'i përkasin palës së tretë të cilës i paguhen sipas policës dhe nuk duhet të përfshihen si pjesë e masës së falimentimit. Përsëri, nuk ka praktikë gjyqësore për një situatë të tillë, por sipas mendimit tonë ky është interpretimi që duhet t'i bëhet LF-së në lidhje me legjislacionin e fondit të pensioneve, fondet e investimeve dhe policat e sigurimit.^[24]

3.3.5. Pasoja në veprimtarinë tregtare dhe marrëdhëniet e punës

Veprimtaria tregtare e debitorit vazhdon edhe pas fillimit të procedurës së falimentimit, pavarësisht nëse të drejtat e administrimit do të vazhdojnë të jenë nën kompetencat e debitorit apo të administratorit të falimentimit.

Në bazë të nenit 61 të LF-së, nëse veprimtaria tregtare e debitorit nuk është e mundur, gjykata mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së debitorit me kërkesë të palëve të përfshira në proces. Kërkesa për pezullim e shoqëruar me arsyetimet përkatëse mund të bëhen nga administratori ose mbikqyrësi i falimentimit, debitori ose komiteti i kreditorëve dhe gjykata e falimentimit autorizon pezullimin nëse kjo është në interesin më të mirë

të kreditorëve. Përpara miratimit të vendimit për pezullimin e veprimtarisë së debitorit, gjykata e falimentimit në çdo rast duhet të dëgjojë administratorin ose mbikqyrësin e falimentimit.

3.4. Pasoja e falimentimit që prekin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë punonjësit e debitorit

3.4.1 Ndikimi i falimentimit në punësim

Humbja e një pune, veçanërisht për shkak të rrethanave që lidhen me falimentimin individual ose të shoqërisë, sigurisht që ka një ndikim negativ te personi që e humbet atë. Kur një debitor ose një prind i prekur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga falimentimi humbet një punë, pasojat në familje ndihen ndjeshëm. Një nga ndryshimet më të dukshme për familjet në situata të tilla është ulja e të ardhurave. Kur një prind humbet punën e tij, shpesh kërkohen ndryshime në stilin e jetës. Duhet të merren vendime se si të shpenzohen paratë që ka, duke lënë pasojat edhe psikologjike të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Rutinat e cilësisë së jetës, të tilla si kujdesi për fëmijët, aktivitetet jashtëshkollore dhe forma të ndryshme argëtimi, shpesh duhet të ndërpriten.

Një pasojë e tillë është theksuar edhe në një studim të Dr. Holly Houston, i quajtur "Ndikimi i humbjes së punës në familje". Studimi thekson se siç shihet në shumë familje, ndryshimet më drastike mund të vijnë nga papunësia. Anëtarëve të tjerë të familjes mund t'u duhet të gjejnë punë ose të rrisin orët e punës. Ky ndryshim mund të sjellë reduktimin e kohës së kaluar së bashku me familjarët dhe të ndikojë në jetën shoqërore të secilit anëtar. Gjetja e punës mund të kërkojë zhvendosjen në një qytet apo edhe një vend të ri. Fëmijët mund të kenë vështirësi dhe të mos pëlqejnë largimin nga shkolla, miqtë dhe rutina e tyre.^[25]

Aktualisht, kuadri ligjor në fuqi, përcakton se si rregull i përgjithshëm, hapja e procedurave të falimentimit nuk cenon vazhdimin e kontratave të punës (neni 78 i LF-së). Në lidhje me këtë, administratori i falimentimit, megjithatë, mund të sugjerojë zgjidhjen ose ndryshimin e këtyre kontratave. Edhe pse zgjidhja ose ndryshimi i kontratave të punës rregullohet përgjithësisht nga Kodi i Punës, falimentimi konsiderohet si një shkak ekonomik real për zgjidhjen ose ndryshimin e kontratave të punës. Gjikata ka kompetencë për të vendosur për çdo rast që lind nga zgjidhja ose ndryshimi i kontratave në fjalë. Gjithashtu, ajo i konsideron punonjësit si kreditorë preferencialë, veçanërisht pretendimet e të cilëve rrjedhin nga zgjidhja e marrëdhënies së punës deri në tre muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, përfshirë rimbursimin e pagës dhe të shëndetit, pagesën e lejes së lindjes, jo më shumë se 500 mijë lekë në total për çdo kreditor. Ajo gjithashtu jep një trajtim preferencial për pretendimet e punonjësve për lëndime personale të shkaktuara gjatë punës. Gjithashtu, ajo që është e rëndësishme, u jep punonjësve mundësinë për të marrë pjesë në komitetet e kreditorëve kur shoqëria ka më shumë se 20 punonjës.

[25] Houston, Holly. 2011. "Ndikimi i humbjes së punës në familje". Qendra e Ankthit dhe Stresit, P.C. Blog, (Shtator). <https://anxiety-stresscenter.com/the-impact-of-job-loss-on-families/>

[24] Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensioneve vullnetare" dhe Ligji nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Qëllimi i studimit tonë, duke marrë parasysh mungesën e të dhënave statistikore për pasojat që falimentimi sjell mbi punëmarrësit, është orientuar drejt analizës së mënyrave të ndryshme të trajtimit ligjor të të drejtave të punëmarrësve në rastin e falimentimit të punëdhënësit. Është e qartë se pasojat e sistemit të falimentimit duhet të mbështeten nga programe aktive të tregut të punës, të tilla si rikualifikimi, ndihma në kërkimin e punës dhe programet e punëve publike. Skemat e sigurimeve ose të fondeve të pensioneve, të cilat janë të reja dhe duke u përhapur në Shqipëri, mund të rrisin gjithashtu ndjeshëm potencialin e punëmarrësve për të kuptuar të drejtat e tyre duke minimizuar rrezikun e falimentimit të punëdhënësve.

3.4.2. Përvoja ndërkombëtare

Që në vitin 1949, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), miratoi Konventën për Mbrojtjen e Pagave^[26] në të cilën trajtonte efektin e paaftësisë paguese mbi pagat e punëtorëve^[27]. Sipas LF-së, në rast falimentimi ose likuidimi gjyqësor të një ndërmarrjeje, punëmarrësit e punësuar në të do të trajtohen si kreditorë të preferuar qoftë për pagat që u takojnë për shërbimet e kryera gjatë një periudhe përpara falimentimit ose likuidimit gjyqësor siç mund të përcaktohet nga ligjet ose rregulloret kombëtare, ose për pagat deri në një shumë të caktuar.

Për të forcuar më tej mbrojtjen e punonjësve në procesin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në vitin 1982, ILO miratoi konventën nr. 158 për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Në Pjesën e II-të, neni 11 i së njëjtës konventë, kërkon që punëdhënësit t'u japin punëmarrësve në prag të papunësisë, ose njoftim brenda një afati të arsyeshëm për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, ose kompensim për mungesë të njoftimit brenda një afati të arsyeshëm. Një pjesëmarrje e ndjeshme dhe e drejtpërdrejtë kërkohet gjithashtu nga përfaqësuesit e punëmarrësve në përfundimin e marrëdhënies së punës, veçanërisht në rastin e ristrukturimeve të mëdha, shkurtimeve ose ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të paaftësisë paguese të punëdhënësit^[28].

Në këtë kontekst, LF-ja ofron trajtim preferencial për punëmarrësit në cilësinë e kreditorëve të preferuar. Punëmarrësi si kreditor i preferuar nuk mund të kërkojë përmbushjen e pretendimit të tij nga pasuritë mbi të cilat rëndojnë garanci të ndryshme (kreditorët e siguruara). Neni 144 i LF-së parashikon shprehimisht se pretendimet e siguruara (p.sh.

[26] Ratifikuar nga qeveria shqiptare me ligjin nr. 8787, datë 07.05.2001.

[27] Nëpërmjet nenit 11 të Konventës: Në rastin e falimentimit ose të likuidimit të ndërmarrjes në bazë të vendimit të gjykatës, punëtorët e punësuar atje duhet të trajtohen si kreditorë të preferuar, lidhur me pagat që u takojnë për shërbimin që kanë kryer gjatë periudhës para falimentimit ose likuidimit mbi bazën e vendimit të gjykatës, sipas dispozitave të legjislationit të vendit, ose lidhur me pagat deri në një masë të caktuar që mund të përcaktohet në legjislationin vendas. Pagat që përcaktohen si detyrim preferencial do të paguhet në plotësi para se kreditorët e zakonshëm të kërkojnë ndonjë pjesë të pasurive. Prioriteti relativ i pagave, që karakterizohen si preferenciale dhe borxheve të tjera të preferuara, përcaktohen nga legjislationi vendas.

[28] Konventa për Zgjidhjen e Marrëdhënies së Punës, 1982 (Nr. 158).

pretendimet e bankave mbi pronat e debitorit, kur janë të siguruara me hipotekë) deri në vlerën e pasurisë që shërben si kolateral, renditen mbi pretendimet e kreditorëve të preferuar (p.sh. pretendimet e punëmarrësve për pushimin nga puna, çështjet e shëndetit dhe punës, shpenzimet e jetesës, etj.).

3.4.3. Kodi shqiptar i Punës dhe pasojat që mund të vijnë nga zbatimi i tij

Neni 124 i Kodit shqiptar të Punës, e përkufizon paaftësinë paguese si gjendjen që lidhet me aktivin e punëdhënësit dhe ka për qëllim të shlyejë kreditorët e tij, si dhe rastet kur nuk mund të shlyhen detyrimet ndaj punëmarrësve për shkak të gjendjes financiare të punëdhënësit. I njëjti nen i jep përparësi pagesës së punëmarrësve, gjatë gjendjes së paaftësisë paguese të punëdhënësit, edhe kur këto pasuri janë të siguruara me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe mbulojnë:

- pretendimet e punëmarrësve për pagat, për një periudhë jo më pak se tre muaj para përfundimit të punësimit;
- pretendimet e punëmarrësit për pagesën e lejes që i takon, si rezultat i punës së kryer gjatë vitit, në të cilin ka ndodhur zgjidhja e marrëdhënies të punës, si dhe gjatë vitit të mëparshëm;
- pagesën për shkurtime nga puna, që i takon punëmarrësit pas përfundimit të marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, ky nen parashikon që detyrimet ndaj punëmarrësve nuk pezullohen me fillimin e procedurës së falimentimit, dispozitë kjo që është pjesë edhe e LF-së në nenin 78 të tij.

Megjithëse, neni 124 i Kodit të Punës në vetvete rregullon statusin preferencial të punëmarrësve gjatë një procesi falimentimi, ne mendojmë se kjo dispozitë është në kundërshtim me LF-në (në veçanti me nenin 38 të tij), edhe pse në një farë mase është në përputhje me nenin 78 të LF-së (për sa i përket mos pezullimit të procedurës së falimentimit), sepse Kodi i Punës praktikisht u jep punëmarrësve të drejta më të mëdha. Për sa i përket shpërndarjes së pasurisë së punëdhënësit, pavarësisht nga fillimi i procedurës së falimentimit apo radhës së preferencës, Kodi i Punës parashikon se pasuritë e punëdhënësit (ose ato që kanë mbetur prej tyre) do të përdoren kryesisht për të paguar punëmarrësit e tij, edhe kur këto pasuri janë të siguruara me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme. Në këtë mënyrë, duket se në rast të falimentimit të punëdhënësit, detyrimet e punëdhënësit ndaj punëmarrësve të tij shmangin parashikimet e LF-së të cilat e vendosin punëmarrësin si kreditor të preferuar. Ky interpretim i yni buron nga hierarkia e normave në rendin juridik shqiptar që e vendos Kodin e Punës në një shkallë hierarkie më të lartë në krahasim me LF-në^[29].

[29] Gjykata Kushtetuese shqiptare me vendimin nr.2, datë 3.2.2010 ka theksuar se, sipas nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi konstaton se ligji dhe akti nënligjor, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me zgjidhjen e çështjes, janë

Duke marrë parasysh vlerësimet e kësaj analize dhe frymën e LF-së në dhënien e një trajtimi preferencial për punëmarrësit që nuk synohet të jetë më i ulët se ai i parashikuar nga Kodi i Punës, ndoshta mund të ketë nevojë për harmonizimin e Kodit të Punës dhe LF-së në mënyrë që Kodi i Punës të ndjekë më qartë rregullat e ligjit të posaçëm në këtë çështje.^[30]

4 Raste praktike mbi ndikimin social të falimentimit tek shoqëritë e mëdha tregtare në Shqipëri

Ndërsa ligji, siç shpjegohet në këtë studim, ka një perspektivë mbizotëruese ekonomike dhe pragmatike, mund të vërehet, edhe pse me hezitim për shkak të mungesës aktuale të praktikës, se nëpërmjet riorganizimit të shoqërisë mund të shpëtohen shumë vende pune dhe si rrjedhojë kjo sjell një ndikim social pozitiv për personat e prekur.

Për të ilustruar sesi riorganizimi nëpërmjet procedurave gjyqësore të falimentimit mund të ofrojë garanci dhe mbrojtje të vazhdueshme financiare dhe sociale për punëmarrësit e prekur nga procesi i falimentimit të debitorit, kemi zgjedhur shembullin e mëposhtëm nga praktika gjyqësore e falimentimit të KURUM INTERNATIONAL Sh.a.^[31]:

Në mënyrë që një plan i riorganizimit të jetë tërheqës për kreditorët dhe që ai të jetë në përputhje me kërkesat ligjore duhet të përmbajë:

KURUM INTERNATIONAL Sh.a. në qershor 2017, gjatë procedurave gjyqësore të falimentimit, kërkoi nga Gjykata e Falimentimit Tiranë miratimin e një plani riorganizimi të shoqërisë. Plani u pranua nga Gjykata me Vendimin nr. 6631/1112 datë 30.06.2017.

Qëllimi i planit të riorganizimit ishte sigurimi dhe ruajtja e veprimtarisë kryesore të shoqërisë dhe njëkohësisht shlyerja e të gjitha detyrimeve të saj me kreditorët nëpërmjet sigurimit të mjeteve bazë për vazhdimin e veprimtarisë prodhuese dhe tregtare të shoqërisë. Plani i riorganizimit përcaktonte edhe mënyrën se si duhet të administrohen mjetet financiare për të arritur përfitimin më të mirë ekonomik nga këto fonde dhe për të mundësuar krijimin e bilanceve monetare për shlyerjen sipas një marrëveshjeje të re të të gjitha detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve.

[31] Kurum International Sh.a. është një shoqëri shqiptare e regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në prodhimin dhe tregtimin e çelikut, shufrave të hekurit dhe materialeve të tjera të ndërtimit. Ky aktivitet bazohet në punën e Fabrikës së Çelikut, për prodhimin e fletëve të çelikut, Fabrikës së Petëzimit për prodhimin e shufrave të hekurit, si dhe Fabrikave Mbështetëse, Fabrikës së Oksigjenit dhe Fabrikës së Gëlqeres, të cilat prodhojnë oksigjen dhe gëlqere si lëndë të para në procesin teknologjik të prodhimit të çelikut.

në kundërshtim me njëri-tjetrin, ai është i detyruar të mbështetet në ligj. Gjyqtarët duhet gjithashtu të marrin parasysh marrëdhëniet ndërmjet ligjeve të miratuara nga tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligjet me shumicë të cilësuar duke përfshirë edhe Kodet), në përputhje me nenin 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara në përputhje me rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta u jep ligjeve me shumicë të cilësuar fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007). Ndjekja e hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe koherencës në sistemin juridik. Për rrjedhojë, në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme ligjore, norma me fuqi më të lartë ka përparësi ndaj normës tjetër (lex superior derogat inferiori). Parimet që përcaktojnë se norma specifike ka përparësi ndaj normës së përgjithshme (lex specialis derogat generali) dhe se norma e hyrë në fuqi më vonë ka përparësi ndaj normës së mëparshme, nuk zbatohen në raste të tilla.

[30] Për sa i përket proceseve legjislativë, do të ishte më e lehtë të ndryshohej LF-ja duke përfshirë dhe përjashtime siç parashikohen në Kodin e Punës dhe jo anasjelltas, pasi Kodi i Punës është një ligj që kërkon një shumicë të cilësuar votash në parlament për t'u ndryshuar.

Plani i riorganizimit, për shkak të fushës së veprimtarisë të shoqërisë që lidhej me prodhimin e çelikut, përfshinte një numër të konsiderueshëm punonjësish të cilët punonin si në nivel fabrike ashtu edhe në atë administrativ.

Duke qenë se pjesa më e madhe e punës së shoqërisë ishte e përqendruar në impiantet e saj prodhuese, këto të fundit ishin ato që u ndikuan më shumë nga procesi i riorganizimit:

- 102 punonjës janë kthyer në punë në fabrikën e laminimit të shoqërisë;
- 120 punonjës u rikthyen në punë në 4 termocentralet e shoqërisë;
- 20 inxhinierë teknikë u kthyen në punë dhe mbikqyrin fabrikat e shoqërisë.

Numri i përgjithshëm i punonjësve para hapjes së procedurave të falimentimit ishte afërsisht 500.

Duhet theksuar se për shkak të procesit të riorganizimit, të gjithë punonjësit përveç Inxhinierëve Teknikë u kontraktuan me kontrata afatgjata, për aq kohë sa uzinat do të funksiononin, duke mos e ngarkuar shoqërinë me kosto të mëtejshme financiare për periudhën e riorganizimit.

Përfundime

Vështirësia financiare është një rrezik i natyrshëm i veprimtarisë sipërmarrëse. Pasojat e falimentimit janë gjithmonë fatkeqe dhe mungesa e burimeve financiare për të kënaqur të gjithë kreditorët përbën stres dhe domosdoshmërisht shkakton pakënaqësi tek njerëzit. Sistemi i falimentimit përpiqet të shtojë mundësinë e parashikimit të këtyre situatave. Mungesa e një regjimi kolektiv që organizon pretendimet e kreditorëve e cila siguron një radhë preferimi (përfshirë një trajtim preferencial të pretendimeve të punonjësve), do të ishte e dëmshme si për vazhdimësinë e një biznesi potencialisht të qëndrueshëm (dhe, rrjedhimisht, vazhdimin e kontratave të punës), ashtu dhe për përpjekjet për rikuperimin e kreditorëve. Kjo është arsyeja pse një kuadër institucional për falimentimin që funksionon mirë minimizon kostot e përgjithshme sociale. Ky kuadër institucional duhet të sigurojë rezultate brenda afateve të arsyeshme dhe duhet të fitojë besimin e palëve të interesuara dhe publikut të gjerë për funksionimin e tij.

Në këtë drejtim, LF-ja favorizon rikthimin e bizneseve në një gjendje të qëndrueshme, ndryshe nga metoda tradicionale e likuidimit të një biznesi në vështirësi financiare. Kjo metodë, ndër përfitimet e tjera për ekonominë, shpesh ndihmon në ruajtjen e vendeve të punës ose reduktimin e shkurtimeve të vendeve të punës. Edhe në një kontekst më individual, LF-ja parashikon përfitime për një fillim të ri brenda një periudhe të arsyeshme kohore, me kosto mjaft të ulëta si për debitorët ashtu edhe për kreditorët e tyre.

Ky studim është rezultat i drejtpërdrejtë i interpretimit dhe analizës së LF-së në raport me pjesë të tjera të legjisllacionit shqiptar, duke u shqyrtuar në kontekstin e pasojave që lindin ndaj debitorëve dhe personave të tjerë të prekur nga procedura e falimentimit. Ky tekst thekson rëndësinë e të kuptuarit të asaj që mund të sjellë e ardhmja për mjedisin social shqiptar bazuar në përvojat e vendeve të tjera. Tema mbi ndikimin e LF-së në një kontekst social është një temë e re dhe do të nevojitet analizë e mëtejshme pasi të mblidhen të dhëna të mjaftueshme.

Studimi përshkruan lidhjen funksionale midis LF-së dhe ligjeve të tjera që prekin aspektet sociale. Si i tillë, ai thekson përfitimin e të pasurit legjisllacion mbështetës për ata individë të prekur në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë nga falimentimi (p.sh. programet e zhvillimit të aftësive). Ai thekson gjithashtu mungesën e të dhënave specifike brenda vendit për këtë temë. Përpjekjet e mëtejshme për të vazhduar me një studim më të detajuar do të ishin të dobishme. Drejtimet e mundshme për hulumtim të mëtejshëm përfshijnë:

- a) Renditjen dhe pasqyrimin në një regjistër të të gjithë individëve të falimentuar;
- b) Zhvillimin e pyetësorëve për të parë pasojat sociale të falimentimit të individëve në rutinën e tyre të përditshme pas procedurës së falimentimit;
- c) Depozitimin dhe mbajtjen e të dhënave për të gjithë punonjësit e pushuar nga

puna për shkak të procedurave të falimentimit të shoqërive tregtare.

Informacioni shtesë mund të lejojë analiza më të detajuara dhe konkluzione të orientuara mbi pasojat sociale të falimentimit, por do të krijojë gjithashtu mundësinë për të informuar agjencitë e tjera të mbrojtjes sociale për të monitoruar mirëqenien e këtyre qytetarëve.



Projekti zbatohet nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG) dhe me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Z. Igor Matijevic

Menaxher Rajonal për Programin

e-Mail: imatijevic@ifc.org

Znj. Irena Gribizi

Koordinatorë e Projektit për Shqipërinë

e-Mail: igribizi1@ifc.org



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO